



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 274/2/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga :

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.07.2020, shqyrtoi çështjen me

Objekt: 1. Korrìgjim Vendimi

Subjekte të interesuar: Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Rruga “Sami Frashëri” nr.10, Tiranë

Agjencia e Prokurimit Publik
*Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Këshilli i Ministrave,
Tiranë*

“Vëllezërit Hysa” shpk
Banjë e re, Klos NjA Cërrik Elbasan

“Bean” shpk & “ED Konstruksion” shpk & “Almo
Konstruksion” shpk & “Kombi Invest” shpk
Rruga “Frederik Shiroka”, Ndërtesa 6, Hyrja.10, Ap.6
Tiranë

BazaLigjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”,
indryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të
Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e
Rregullave të Prokurimit Publik”, indryshuar, Vendimi i
Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë

12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”; Neni 112 i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni i Prokurimit Publik,

Vëren:

Në datën 24.07.2020 përmes Vendimit KPP 274/2020, KPP në pikën 2 të dispozitivit, është shprehur si më poshtë vijon:

- 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e BOE “Bean” shpk & “ED Konstruksion” shpk & “Almo Konstruksion” shpk & “Kombi Invest” shpk duke e kualifikuar atë.*

Komisioni i Prokurimit Publik

Arsyeton:

I.1. Me nismën e vetë organit administrativ, nga Komisioni i Prokurimit Publik, konstatohet se në Vendimin KPP 274/2020 të datës 24.07.2020, KPP është shprehur duke bërë një lapsus në citimin e pikës 2 të dispozitivit për procedurën e prokurimit objekt ankimi, si vijon:

- 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e BOE “Bean” shpk & “ED Konstruksion” shpk & “Almo Konstruksion” shpk & “Kombi Invest” shpk duke e kualifikuar atë.*

Për sa mësipër, në mbështetje të nenit 64 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” dhe nenit 112 i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

- 1. Të korigjojë Vendimin KPP 274/2020 të datës 24.07.2020 (ishte):**
- 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e BOE “Bean” shpk & “ED Konstruksion” shpk & “Almo Konstruksion” shpk & “Kombi Invest” shpk duke e kualifikuar atë.*

(bëhet):

2. *Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e BOE “Bean” shpk & “ED Konstruksion” shpk & “Almo Konstruksion” shpk & “Kombi Invest” shpk duke e skualifikuar atë.*

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri